

DHJETOR 2019

Ndonjëherë është e lehtë ta humbasësh kuptimin e vërtetë të Krishtlindjes në ngazëllimin për dritat vezulluese dhe banketet festive. Por Krishtlindja i kushtohet e gjitha nderimit të Jezu Krishtit. Përdoreni këtë kalendar kurdoherë që ju nevojitet ta kujtoni arsyen e vërtetë për kremtim. Nëse e kapërceni një ditë, mos u shqetësoni! Shërbeni kur të mundeni dhe kujt të mundeni. Dhe mbajeni mend se ju mund të merrni pjesë në nismën #NdriçojeBotën gjatë të gjithë vitit – çdo ditë është një mundësi për të qenë pak më shumë si Jezusi.

E DIELE

01

Ftoje dikë të marrë pjesë bashkë me ty në një shërbim adhurimi për Krishtlindje këtë muaj.

E HENE

02

Mendo për dikë që është shembull shërbimi si i Krishtit. Thekso shembullin e tij/saj në rrjetet shoqërore.

E MARTE

03

Dhuro gjak sot. Shërbimi yt vetëmohues mund të shpëtojë një jetë.

E MERKURE

04

Cilin nga shokët/shoqet e klasës ose kolegët/et e njeh më pak? Ha drekë me dikë që është i/e ri/e në shkollë apo punë.

E ENJTE

05

Bëj një lutje mirënjohjeje për Jezu Krishtin dhe mëshirën e Tij.

E PREMTE

06

Gjej një mënyrë për ta ndihmuar dikë në nevojë në mbarë botën duke bërë dhurime në një organizatë bamirësie të respektuar.

E SHTUNE

07

Mendo për pjesëtarët e familjes sate. Dil vullnetar për t'ua pastruar dhomat ose për të bërë ndonjë vepër tjetër shërbimi për ta.

08

Tregoji një shkrim të shenjtë një shoku/shoqeje ose një njeriu të dashur që sot mund të ketë nevojë për t'i dhënë zemër.

09

Jepi mjet ngrohës për duart dikujt që e kalon ditën jashtë.

10

Jepi zemër dikujt! Bëj plane për të marrë pjesë në një ngjarje (feste, atletike, kulturore etj) që ta përkrahësh dikë që njeh.

11

Thuajti një pjesëtarit të familjes pikërisht tani se sa shumë e do dhe e vlerëson atë.

12

Shprehu se si ndihesh për Jezu Krishtin duke bërë vepër artistike, duke kompozuar një këngë, një poemë ose ndonjë gjë tjetër krijuese dhe tregojta atë një shoku/shoqeje ose një njeriu të dashur.

13

Shkruaj një pusullë falënderimi anonime për shefin/en, mësuesin/en ose udhëheqësin/en tënde dhe bëji të ditur se çfarë e bën mirë.

14

Planifiko një veprimtari vetëm për vetëm me një shok/shoqe ose një njeri të dashur.

15

Kur të marrësh një mesazh me celular sot, thuajti personit që ta dërgoi, diçka që e vlerëson tek ai/ajo.

16

Mëso për një nga paraardhësit tënd dhe tregojë historinë e tij ose të saj. A ke nevojë për ndihmë? Vizito faqen FamilySearch.org

17

Bëj një zotim për të qenë pozitiv sot. Përhëndete këdo që sheh, me një buzëqeshje.

18

Mendo për dikë për të cilin/en ke pasur ndjenja negative kohët e fundit. Përpiqu të lutesh për të.

19

Jepi ndihmë një personi të moshuar për një punë të zakonshme shtëpie.

20

Dhuro artikuj në dyqanin me mallra të përdorura ose në organizatën për bamirësi në zonën tënde, ose jepja ato dikujt në nevojë.

21

Mendo për një prind të vetëm që njeh. Ftoje/ji të qëndrojnë/në me ty fëmijën/fëmijët e tij/saj kështu që prindi të mund të ketë pak kohë për të bërë përgatitjet për Krishtlindjen ose punë të tjera të zakonshme shtëpie.

22

Kërkoji Perëndisë që të jesh përgjigjia për lutjen e dikujt tjetër sot.

23

Mendo për një fqinj që nuk e njeh shumë mirë. Çoji atij ose asaj disa qerasje të bëra në shtëpi ose një dhuratë të menduar mirë.

24

Jepi një pjesëtarit të familjes një "listë ku mund të zgjedhësh gjërat që dëshiron". Hidh në letër të gjitha gjërat e mrekullueshme, kuptimplote që ai ose ajo ka siguruar për ty gjatë gjithë jetës sate.

25

Gëzuar Krishtlindjen! Mendo për të gjitha gjërat që Shpëtimtari Jezu Krisht ka bërë për ty dhe tregojti disa prej tyre në rrjetet shoqërore.

26

Shndërrojë ftesën Ndriçoje Botën një e nga një çdo ditë në një synim për Vitin e Ri.



A dëshironi ta shkarkoni këtë kalendar dhe të shikoni materialet filmike për Krishtlindjen? Vizitoni faqen NdriçojeBoten.org